



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A.nr. 283/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muhamet Rexha kryesues, Hasan Shala dhe Ferit Osmani anëtarë, duke vendosur përkitazi për kërkesën e subjektit politik Lëvizja për Bashkim (LB), në seancën e panelit të mbajtur me 25.10.2013, mori këtë:

V E N D I M

Konstatohet e tërhequr ankesa me numër: Anr.265/2013, e datës 17.10.2013, të parashtruar në PZAP nga Lëvizja për Bashkim (LB).

Arsyetim

PZAP, me datë 18.10.2013, ka pranuar një kërkesë për tërheqjen e ankesës me numër: Anr. 265/2013, datës 17.10.2013, të parashtruar në PZAP, kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), në të cilën kërkohet që të tërhiqet ankesa e lartpërmendur nga shqyrtimi, pasi subjekti politik LDK ka bërë përmisimin e shkeljes së pretenduar.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi kërkesën për tërheqje të ankesës së sipërshënuar, me të cilën kërkohet nga PZAP-i që mos të shqyrtohet ankesa në fjalë, në kuptim të nenit 115.1 të LZP-së, PZAP-i vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

A nr. 283/2013 më datën 25.10.2013

Kryesuesi i Panelit
Muhamet Rexha

